



## LËNDA MËSIMORE: NDIHMA E PARË

<b>Klasa:</b>	<b>Klasa 11</b>
<b>Titulli i Kualifikimit:</b>	<b>Asistent Dentar</b>
<b>Vlera e Kredive të Modullit:</b>	<b>1.75 Kredi (35 orë mësimore)</b>
<b>Niveli i Modullit në KKK:</b>	<b>Niveli 3 i KKK</b>
<b>Rezultatet Mësimore (RM) të Modullit: Ndhimja e parë</b>	
<b>RM1:</b> Nxënësi shpjegon nocionin, qëllimet dhe detyrat e ndihmës së parë <b>RM2:</b> Nxënësi demonstroi dhënien e ndihmës së parë gjatë lëndimeve të ndryshme	
<b>RM2: Nxënësi shpjegon nocionin, qëllimet dhe detyrat e ndihmës së parë</b>	
<b>Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi:</b>	
<ul style="list-style-type: none"><li>- Përshkruan ndihmën e parë si nocion</li><li>- Dallon rastet urgjente</li><li>- Përshkruan llojet e lëndimeve</li><li>- Shpjegon procedurën e dhënies së ndihmës së parë</li><li>- Evidenton rastet e lëndimeve të hapura, si plagët dhe thyerjet e hapura</li><li>- Shpjegon mënyrën e ndaljes së gjakderdhjes</li><li>- Zbaton procedurat për ndaljen e gjakderdhjes</li><li>- Shpjegon procedurën e pastrimit të plagëve</li><li>- Zbaton rregullat për pastrimin e plagëve</li><li>- Shpjegon procedurën e fashimit të plagës</li><li>- Zbaton rregullat për fashimin e plagës</li><li>- Shpjegon mënyrën e imobilizimit të përkohshëm në thyerjet e hapura sipas rregullit</li><li>- Imobilizon përkohësisht thyerjet e hapura sipas rregullit</li><li>- Evidenton rastet e lëndimeve të mbyllura (lukstacionet, distorzionet, thyerjet e mbyllura)</li><li>- Zbaton rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes gjatë dhënies së ndihmës së parë</li><li>- Dokumenton veprimtarinë e dhënies së ndihmës së parë</li></ul>	
<b>Kushtet e nevojshme:</b>	
<ul style="list-style-type: none"><li>- Klasë mësimore.</li><li>- Media didaktike si videoprojektor, CD, katalogë me raste të dhënies së ndihmës së parë</li><li>- Komplet i ndihmës së parë</li><li>- Udhëzues pune për dhënien e ndihmës së parë në raste të lëndimeve</li></ul>	
<b>Njohuritë që përveçohen nga nxënësit:</b>	
<ul style="list-style-type: none"><li>- Nocioni, qëllimi dhe detyrat e ndihmës së parë</li><li>- Nocioni i rasteve urgjente</li><li>- Përmbajtja e kompletit të ndihmës së parë</li><li>- Llojet e lëndimeve</li><li>- Procedurat e dhënies së ndihmës së parë</li><li>- Veprimtaritë në vendin e ngjarjes</li></ul>	

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përcaktimi i gjendjes së të lënduarit/sëmuarit</li> <li>- Mënyrat e ndaljes së gjakderdhjes</li> <li>- Procedurat e pastrimit të plagëve</li> <li>- Procedurat e fashimit të plagëve</li> <li>- Teknikat e imobilizimit të përkohshëm në thyerjet e hapura sipas rregullit</li> <li>- Lëndimet e mbyllura (distorzionet, thyerjet e mbyllura)</li> <li>- Nocioni, llojet dhe rëndësia e vdekjes</li> </ul>
<p><b>Shkathësitë që përvetësohen nga nxënësit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Klasifikimi i rasteve urgjente</li> <li>- Dallimi i lëndimeve të hapura dhe të mbyllura</li> <li>- Përpunimi i plagëve dhe fashimi</li> <li>- Imobilizimi i përkohshëm i thyerjeve të hapura</li> <li>- Zbatimi i rregullave të sigurisë dhe mbrojtjes gjatë dhënies së ndihmës së parë</li> </ul>
<p><b>Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Komunikimi korrekt.</li> <li>- Bashkëpunimi.</li> <li>- Punë individuale dhe në grup</li> <li>- Mirëmbajtja e kompletit të ndihmës së parë.</li> </ul>
<p><b>Kërkesat për Vlerësimin e nxënësve:</b></p>
<p><b>Metodat e Vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pyetje –përgjigje me gojë</li> <li>- Pyetje - përgjigje me shkrim (teste të standardizuara/tradicionale)</li> <li>- Vlerësimi i vazhdueshëm i aktivitetit të nxënësit gjatë orës mësimore</li> <li>- Punime seminarike</li> <li>- Prezantime individuale dhe grupore</li> <li>- Listë – kontrolli për aspektet teorike</li> <li>- Detyra përfundimtare</li> </ul>
<p><b>Evidentimi i Vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Test me shkrim që verifikon shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të kriterëve të vlerësimit me karakter teorik</li> <li>- Pyetjet me gojë duhet të jenë me përgjigje të hapura</li> <li>- Zbatojë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes gjatë dhënies së ndihmës së parë.</li> <li>- <u>Kufiri minimal</u> i kalueshmërisë në <i>testin me shkrim</i> është kur nxënësi plotëson 45% të pikëve ndërsa në vlerësimin praktik është kur plotëson 80% të kriterëve të vlerësimit në <i>Listën e kontrollit</i>.</li> </ul>
<p><b>RM2: Nxënësi demonstroi dhënien e ndihmës së parë gjatë lëndimeve të ndryshme.</b></p>
<p><b>Kriteret e Vlerësimit të nxënësit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Analizon vetëdijen dhe faktorët e çrregullimit të saj</li> <li>- Identifikon shenjat e çrregullimit të nivelit të sheqerit në gjak</li> <li>- Dallon llojet e helmimit</li> <li>- Realizon procedurat e reanimimit kardio-pulmonar</li> <li>- Monitoron shenja vitale</li> <li>- Dallon dhe përpunon plagët</li> <li>- Menaxhon gjakderdhjet</li> <li>- Zbaton procedurat dhe realizon teknikat e fashimit</li> <li>- Menaxhon sipas rregullave frakturat e hapura</li> <li>- Imobilizon përkohësisht segmentet e caktuara të aparatit lokomotor</li> <li>- Përshkruan llojet e lëndimeve</li> <li>- Menaxhon simptomat e papritura</li> <li>- Dokumenton veprimtarinë e dhënies së ndihmës së parë</li> </ul>

- Zbaton rregullat e mbrojtjes në punë dhe të mjedisit
<b>Kushtet e nevojshme:</b>
- Kabineti i ndihmës së parë i pajisur me mjete dhe mullazhe - Media didaktike si CD, videoprojektor, mjete dhe materiale për kryerjen e ndihmës së parë, mjete bartëse, transportuese. - Udhëzues pune
<b>Njohuritë që përvetësohen nga nxënësit:</b>
- Çrregullimi i vetëdijes, shkaqet dhe klasifikimi - Çrregullimi i nivelit të sheqerit në gjak - Helmimi me alkool, ilaçe dhe gjendja komatoze - Procedura e reanimimit kardio-pulmonar - Procedura e monitorimit të shenjave vitale - Plagët dhe llojet e plagëve - Gjakderdhjet nga hunda goja dhe veshi, ndalja e gjakderdhjes dhe shoku hemorragjik - Materialet për fashim, teknikat dhe procedurat e fashimit - Procedura e menaxhimit të lëndimeve të nyjeve dhe kockave - Procedura e imobilizimit të segmenteve të caktuara të aparatit lokomotor - Lëndimet termike dhe të elektricitetit - Lëndimet kimike dhe biologjike - Lëndimet e kokës, organeve, kafazit të krahërorit, abdomenit dhe komblikut - Krash blast lëndimet, mbytjet dhe aksidentet automobilistike - Menaxhimi i simptomave të papritura (rritja e temperaturës, problemet e zemrës, astma bronkiale, dhimbjet abdominale, vjellja dhe berkqitja, reaksionet alergjike) - Rregullat e komunikimit, të sigurisë dhe mbrojtjes
<b>Shkathtësitë që përvetësohen nga nxënësit:</b>
- Reanimimi kardio-pulmonar - Monitorimit i shenjave vitale - Menaxhimi i frakturave të hapura - Imobilizimi i përkohëshëm - Përgatitja e vendit, mjeteve dhe pajisjeve për imobilizime emergjente - Pozicionimi i trupit të lëndimet e ndryshme emergjente - Përzgjedhja e mjeteve dhe materialeve për imobilizimin e qafës, claviculës, krahut dhe parakrahut, mbigjurit, të nëngjurit, të nyjës së këmbës, të shtyllës kurrizore - Imobilizimi i qafës me qaforen e shanzoëit - Imobilizimi i claviculës me shami trekëndëshe (përpara-majtas dhe pas-djathtas) - Imobilizimi i supit dhe krahut me shami trekëndëshe - Imobilizimi i parakrahut me shami dhe dërrasë - Imobilizimi i mbigjurit me dërrasë - Zbatimi i rregullave të komunikimit, të sigurisë dhe mbrojtjes
<b>Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësit:</b>
- Komunikimi korrekt. - Bashkëpunimi. - Punë individuale dhe në grup - Mirëmbajtja e kompletit të ndihmës së parë
<b>Kërkesat për Vlerësimin e nxënësve:</b>
<b>Metodat e Vlerësimit:</b>
- Pyetje –përgjigje me gojë - Pyetje - përgjigje me shkrim (teste të standardizuara/tradicionale) - Vlerësimi i vazhdueshëm i aktivitetit të nxënësit gjatë orës mësimore - Punime seminarike

- Prezantime individuale dhe grupore
- Listë – kontrolli për aspektet teorike
- Detyra përfundimtare

**Evidentimi i Vlerësimit:**

- Test me shkrim që verifikon shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të kriterëve të vlerësimit me karakter teorik
- Pyetjet me gojë duhet të jenë me përgjigje të hapura
- Kufiri minimal i kalueshmërisë në *testin me shkrim* është kur nxënësi plotëson 45% të pikëve ndërsa në vlerësimin praktik është kur plotëson 80% të kriterëve të vlerësimit në *Listën e kontrollit*.